

### For a history of the Feminist movement in Albania

**Abstract:** The study aims to historically reconstruct the phases of the beginning and the spreading of the Feminist movement in Albania in the first half of the 20th century.

Feminism in Albania was born in special historical conditions and there was not just one impulse and inspiration. The movement interwove the themes of the Christian thought, inspiration by the practical reaction of the Kemalist movement in Turkey, European experience of Feminism and the Marxist ideology of proto-Communist groups in Albania from the 1930s. The author underscores the need to elaborate an authentic scientific methodology of such movement so little known and, a deeper understanding of the ups and downs of its itinerary. All this is contemplated in function of the awakening of a new Feminist awareness in Albania, serving the cause of the woman's rights and her values in society without manipulating such cause for political purposes.

**Keywords:** *Albanian Feminism, Albania, Shaqe Çoba, Parashqevi Qiriazi, Ollga Plumbi, Association 'Grueja Shqyptare'.*

Me u përpjekë me ndërtue historinë e lëvizjes feministe në gjysmën e parë të shekullit XX në Shqipëri nuk asht një gjë e lehtë, tue qenë se shtrembnimet ideologjike që pasuen në gjysmën tjetër të atij shekulli, heshtja ndaj aktivitetit të disa personaliteteve të kësaj lëvizje, botëkuptimi i të cilave nuk përputhej me ideologjinë komuniste, harresa e qëllimshme që mtonte me ba me përkue zanafillën e lëvizjes emancipuese me ardhjen në pushtet të regjimit komunist, kanë lanë aq shumë gjurmë në historiografi, sa që rezulton dispersiv mundi me konsultue një literaturë të tanë që asht prodhue mbas vitit 1944, shi për mungesën e spesorit shkencor dhe të akribisë metodologjike.

Dekadat 1920-1940, të cilat shenjojnë dinamikën e lëvizjes feministe në Shqipëri, përkojnë me atë që konsiderohet si vala e parë e feminizmit botnor e që gjithsesi nuk mund të identifikohet *tout court* me asnjë prej rrymave që gjejmë në Shqipëri, edhe pse tharret gjinden në trajta të ndryshme tek secila prej tyre.

Lëvizja feministe shqiptare nuk mund të mendohet e ndame prej frymës së Pamvarsisë, tek e cila ka rranjë të veta logjike.

Me datën 3 gusht 1920 në Shkodër themelohet Komiteti i Zojave “Grueja Shqiptare” me qëllime bamirësije. Neni dy i statutit përcakton se qëllimi i këtij Komiteti është me mbledhë ndihma për ushtrinë kombëtare që luftonte asokohe në Koplak dhe për viktimat civile të luftës. Komiteti ishte i organizuem me mbledhëse ndihmash, spedicionere, këshilltare, ekonomet, infermiere, aktiviste.

Kryetare nderit zgjidhet zoja e Hysen beg Bushatit, kryetare është aktivistja Shaqe Çoba, nënkryetare Age Koka, sekretare Paulina Leka e arkëtare Albina Ashiku. Mandej vijnë ekonomet: znj. e Hasan Bekteshit, Marta Saddedin, Çija e Cin Sumës, Zina Ashiku, znj. e Maliq beg Bushatit, znj. e Fahri Begut, znj. e Rauf Begut, zojushë Kusha Kadarja, znj. Tina e Gurakuqit e një varg këshilltaresh. Në fund të proceverbalit lexojmë: “Me gëzim të shpirtit pelqehet kjo vepër atdhetare”.<sup>1</sup>

Po atë vit në Shkodër u themelue edhe organi i këtij komiteti, e përkohshmeja “Grueja Shqiptare” e cila botohej në Shtypshkronjën Françeskane. Në numrin e saj të parë botohet kryeartikulli me titull “Programi i jonë”, i cili sqaron se përparimi i shoqërisë është i lidhur me familjen e kjo e fundit është e përbërë prej burrit e grues, e kësodore Komiteti tue pa nevojët e familjes e rolin e grues në edukimin e fëmijëve, ka vendosë me e ndihmue gruen shqiptare në përparim në udhë të kulturës dhe të qytetnimit.<sup>2</sup>

Në numrin pasues të revistës një editorial me titull “Vajzës shqiptare” që për kah stili të kujton Fishtë, fton shqiptaren me u stolisë me virtyte e jo me u bjerrë me marrina, mbasi grueja është e krijueme për jetën shtëpiake e duhet të dijnë me mbarështue shtëpinë, fëmijët tue qenë se është “mretëshë në familje”.<sup>3</sup>

Interesante është edhe polemika që ma vonë shpërthen mes një artikullueshkruesi me pseudonimin Minerva, autor i një shkrimi me titull *Familja dhe Gegë Toskës* (Atë Gjergj Fishtës).<sup>4</sup> Tezave historike me karakter naiv të Minervës, Fishta i kundërvihet tue saktësue origjinën historike të familjes dhe njëkohsisht natyrën e saj të epërme. Me shumë interesë është shkrimi i Parashqevi Qiriazi “Programi i Shoqërisë së zonjave Grueja Shqiptare në gjytet të Tiranës. Për përparimin e grues Shqiptare n’arsim dhe për ndihma bamirësi”.

1 AQS F 847, 1920, D176. Me shumë gjasa, tue gjykue prej kaligrafisë, procesverbali i mbledhjes themeluese është mbajtë prej Atë Gjergj Fishtës. Shihet në dokumentet e kohës tara historike sidomos e pjesës myslimane ku gratë nuk përmenden me emnin e tyre por me emnin e bashkëshortit.

2 *Grueja Shqiptare*, 1920, nr. 1.

3 *Grueja Shqiptare*, 1920, nr. 2, ff. 9-10.

4 Shih: *Grueja Shqiptare*, 1921, nr. 3, ff. 17-19 dhe nr. 4., ff. 25-28.

Qiriazhi i drejton një letër Drejtorisë të së Përkohshmes “Grueja Shqiptare” në Shkodër me të cilën lajmëron se *me 27 të Dimërorit 1920 u themelue në Tiranë Shoqëria në fjalë*. Qëllimi i saj, thekson ajo, asht përparimi në arsim dhe bamirësia. Shoqnia organizon mbledhje për çdo javë dhe ka hapë katër klasë mësimesh shqip për gra që nuk kanë pasë rast me shkue në shkollë, aty mësohet shqip, frëngjisht, anglisht dhe punë dore.

Ajo shprehë besimin dhe shpresën se do të ketë një letërkëmbim dhe sidomos bashkëpunim mes parive të shoqnive të qyteteve tjera. Në vijim gjejmë rregulloren e shoqnisë së sapoformueme.<sup>5</sup>

Në numrin pasues një artikullshkruese që nënshkruhet: “Një pjestare e Komitetit”, boton artikullin me titull: “Qëllimi i veprës së Komitetit Grueja Shqiptare”, ku nënvizon faktin se shoqnia ka dërgue ndihma në front për ushtarët që luftojnë për tansinë toksore, ka ba vizita në smuatore, iu ka dhanë ndihma të damtuemve prej lufte, e shton se disa prej grave madje shkuene vetë në front me inkurajue ushtarët, të cilët i trajtojnë si vëllezën. Gratë, vëren artikullshkruesja, kanë kontribue me nga dy korona argjendi për krye në çdo muej e shton me keqardhje se deri atëherë grueja shqiptare asht trajtue tepër keq para burrit, por sot ka nisë me shndritë drita e qytetnise, nepër të cilën grueja shqiptare ka nisë me u nderue e me u çmue. Shkrimi përfundon tue pohue se *ne granía duhet të ndjekim gjurmat e grave të Europës n’daçim me u librue prej asaj zgjedhë në të cilën jemi e të mbërrijmë në një shkallë nderimit ku shohim gratë e botës*. Thelbi emancipues i artikullit qëndron tek idea se grueja asht shpirti i shoqnisë njerzore dhe qendra e familjes.<sup>6</sup>

Në po atë numër një shkrim me titull “Zakonet t’ona”, i nënshkruem nga “Një grue shkodrane”, stigmatizon zakonet e mbrapshta, sidomos ato që kanë të bajnë me mortin.<sup>7</sup>

Po e njejta pendë boton edhe artikullin “Feminizmi”, ku vehet në dukje se grueja asht qendra, shpirti i njerzimit, ajo përmirëson e hijeshon familjet, ndiesinat e kandshme, dhe se grueja shqiptare e stolisun prej Perendís ka të drejtë me qenë e lirshme, mbrenda caqeve të urtís e të njerzís, në këtë suazë ajo kërkon lirinë e vet pa hjedhë mbas shpine moralitetin. Artikullshkruesja citon fjalët e Filip Shirokës: “Shqypnia ka burra qi s’dien se ç’asht friga e ka vasha qi s’dien se ç’asht flliga”, dhe vijon besimplote se grueja shqiptare ka me këputë prangat e një robnije që e poshtnojnë dhe e molisin e ka me ndjekë lirinë e vërtetë, atë që mbështetet në moralitetin ma të kulluet, dhe vetëm atëherë grueja shqiptare ka me u vu në udhë të qytetnimit baraz me shoqet e veta të gjitha viseve të botës së qytetnueme.<sup>8</sup>

5 *Grueja Shqiptare*, 1921, nr. 5, ff. 34-37.

6 *Grueja Shqiptare*, 1921, nr. 6, ff. 41-43.

7 Po aty, ff. 44-46.

8 *Grueja Shqiptare*, 1921, nr. 7, ff. 49-51.

Po kjo aktiviste, me shumë gjasa Shaqe Çoba, boton edhe artikullin “Zakonet t’ona”, ku shprehet kundër përdorimit të veshjes së vjetër nga ana e grave dhe nevojën e veshjes alla franga.<sup>9</sup>

Edhe e përkohshmja “Agimi”, organ i Shoqnisë “Vëllaznija” në vitet 1919-1922, e drejtuese fillimisht prej Kristo Floqit e ma vonë prej Karl Gurakuqit, do të bahej votër e emancipimit të grues në shoqinë shqiptare. Tue nisë prej numrave të parë Kristo Floqi do të përpiquej me paraqitë figura të ndrituna grash shqiptare në lamijen e kulturës, tue portretizue veçan personalitete si Dora D’Istria, Cristina Schirò, Sevasti Dako dhe Parashqevi Qirjazi.<sup>10</sup>

Edhe një autor i paidentifikuem prej nesh, që nënshkruen me inicialet A. J. artikullin “Nevojat e arsimit për femna”<sup>11</sup>, i referohet veprës *Traité de l’éducation des filles* (1687) të François Fénelon, tue theksue gabimin e nënçmimit të nevojës së arsimit për femnat, me arsyetimin se meqë janë të destinueme me ndejtë në shtëpi s’ka çka u vlen shkolla. Simbas autorit gratë kanë detyra të nalta, ato qeverisin shtëpinë, kanë një pushtet të natyrshëm në votrën familjare, janë kujdestare dhe ua pret mendja për gjithçka. Gratë kanë një peshë të madhe në shoqni, edukojnë fëmijët, janë burim virtytit, çrregullimi i gjendje së tyne e damton shoqin njerzore pse ato jane “gjysma e gjinise njerzore”.

Shohim kështu së parit argumentin sasior, pra meqë numri i grave në shoqni asht sa gjysma e kësaj, atëherë asht gja e arsyeshme nxjerrja e tyne prej gjendjes së mjerueshme në të cilën ndodhen.

Në numrin shkurtit 1921, Karl Gurakuqi boton tek *Agimi* një bisedë të tijën me Terenc Toçin<sup>12</sup>, asokohe drejtor i fletores *Taraboshi* që botohej në Shkodër. Toçi vëren se feminizmi asht si liria, edhe në bolshevizëm ka liri e ka një lloj feminizmi që asht poshtnimi i grues. Simbas tij feminizmi i vërtetë, ai i moderuemi, nuk i prish zakonet e popujve, mbasi në vendet e mbrapambetuna ka ma shumë prishje zakonesh sesa në vendet që promovojnë emancipimin e grues. Toçi lëvdon rolin e besimit fetar dhe nënvizon sesi Lufta Botnore ishte ajo që i prishi zakonet dhe se janë burrat ata që i çojnë gratë në rrugë të keqe. Ai e idealizon gjendjen morale të grave shqiptare tue e konsiderue atë si të paprekun dhe sugjeron se në shkolla do t’i jepte me lexue të rejave shqiptare krahas Biblës dhe Kuranit edhe *Jetë paralele* të Plutarkut.

Një polemikë e fortë mbi çështje të feminizmit lindë në vitin 1921 mes Hoxha Kadrisë dhe Mati Logorecit (shih: *Feminizmi. Letër e hapun mikut*

9 *Grueja Shqiptare*, 1921, nr. 8, ff. 57-61.

10 Shih: *Agimi*, qershtuor 1919, nr. 2, ff. 17-19; shih: *Agimi*, nandor 1919, nr. 7, ff. 101-102; *Agimi*, tetor 1919, nr. 8.

11 *Agimi*, maj 1920, nr. 1, ff. 3-4.

12 *Agimi*, fruer 1921, nr. 10, ff. 139-144.

*t'em të dashtun Zotni M. Logorecit*), ku Hoxha Kadria prej pozitive të një atdhetari dhe kleriku mysliman të moderuem kritikon degjenerimin e grues në Europë dhe mbron parimet islame. Nuk mungojnë tonet ironike në shkrimin në fjalë në lidhje me moshën e shtymë të Logorecit për meqenë pjesë e një partie feministe në Shqipëri. Autori shprehet pasaktësisht se në Perëndim nuk ekziston ligja që kompenson çvirgëlimin e një femre apo tutelon të drejtat e saja me kërkue atësinë e fëmijës, me tregtue, me lanë trashigimi. Feminizmi simbas tij asht kundër ligjeve të natyrës, ndërsa grueja myslimane e ka marrë rrugën e përparimit tue nisë prej burimesh të shëndetshme dhe gratë në Perëndim nuk e androjnë as gjysmën e lirive e të drejtave të grave myslimane. Kafazat dhe çarçafat, thjeshtëzon diskursin Hoxhë Kadria, nuk janë pengesa e të qenit të lumtun në shoqni, ndërsa futja e grues në qarqe burrash, hapja e nëpunësive e mjeshtrive, asht fikja e një ylli prej kupës së qiellit dhe kjo gja do të ketë pasoja në demografinë e vendeve të interesueme.<sup>13</sup>

Edhe në letrën drejtue Mati Logorecit me titull "Prap feminizmi"<sup>14</sup>, Hoxha Kadria vijon polemikën me Mati Logorecin, mbas reagimit të ashpër të këtij në numrin e maparshëm të *Agimit*. Kleriku mysliman shprehet pro një feminizmi të moderuem dhe e konsideron si një fatkeqsi shartimin e feminizmit european tek grueja shqiptare. Ai ven në dukje degjenerimin e grues në vendet perëndimore si Angli e Gjermani, ku morali i grues asht zvetnue. Gjithashtu nuk e humbë rastin me polemizue edhe me një artikull të Halim Xhelos tek *Mbrojtja komtare* (nr. 16) e datës 27 janar 1921, ku Xheleja shprehej për heqjen e çarçafave të grave myslimane.

Mundësinë që grueja të jetë e barabartë me burrin tue u ushtue në profesionet që ban ai dhe tue u shkollue prej lindjes deri në vdekje, Hoxha Kadria i kundërven një shkollim të mjaftueshëm për rolin e grues në shoqni, e prej saj, thotë ai, priten ma fort vepra prej gjylpanës me të cilën qendisë sesa prej pendës. Vetëm dy janë temat, përfundon ai, në të cilat asht dakord me feminizmin e moderuem të Terenc Toçit: divorci dhe poligamia, vetëm në këto pika ai asht i gatshëm me ba aleancë me kolegët e tij intelektualë progresista.

Në një shënjim të botuesit të *Agimit*, lexojmë kënaqësinë e Redaksisë së kësaj reviste për hapjen e debateve të tilla, ta pazakonta e të mirëprituna për pjesën përparimtare të shoqnisë së asaj kohe.

Në një artikull të mavonshëm me titull "Feminizmi. Martesa e kunorshme", Hoxha Kadria tregon rreziqet që i kërcënohen martesës tradicionale prej disa kërkesave të feminizmit që relativizojnë karakterin e epërm të martesës.<sup>15</sup>

13 *Agimi*, kallnduer 1921, nr. 9, ff. 124-127.

14 *Agimi*, mars 1921, nr. 11, ff. 154-159.

15 *Agimi*, maj 1921, n. 1, ff. 2-6.

Nji tjetër e përkohshme, jetëshkurtë madje, që do të trumpetonte idealet e emancipimit të femnës do të ishte edhe *Mbleta*, organ i shoqnisë së grave të Korçës “Përlindja”, që kishte si drejtuese Evdhoksia Th. Gërmenjin, numri i parë i të cilit do të dilte në janar të vitit 1922 në Korçë. Shoqnia “Përlindja” u themelue me 6 prill 1919 nën kryesinë e zonjës Thomaidha G. Raci e tue nisë prej vitit 1921 në atë post u zgjodh Evdhoksi Th. Gërmenji. Zëvendëssekretare ishte znj. Helidhoni Falli, kurse ma përpara ishte sekretare znj. Evgjëni Ll. Rafail. “Përlindja” ishte mjaft aktive aq sa themeloi 11 degë, në Pojan, Zëmlak, Plasë, Dishnicë, Kolanec, Dvoran, Mborje, Pogradec, Kamenicë, Bilisht, Progër. Karakteristikë tjetër e kësaj shoqnie ishte tendenca pozitive me krijue marrdhanje me shoqnitë motra në botë si psh. me Bashkimin e Grave të Gjenevës dhe me shoqinë “Bijat e Shqipërisë” në Jamestown (USA). Vetëdijen për këtë mision bashkëpunues e gjejmë edhe në numrin pasues, kur i bahet thirrje shoqnive të grave shqiptare mbrenda vendit dhe në kolonitë e hueja të bashkëpunojnë ngusht me njena-tjetrën, të shkëmbejnë programet dhe të forcojnë vetëdijen për përparimin e kombit.<sup>16</sup>

Në vazhdën e kësaj rryme mund të konsiderohet edhe kontributi i Lumo Skendos me titull “Plagët t’ona”, i botuem së pari në tre numra të *Revistës pedagogjike* në vitin 1924. Autori ndër plagët e shoqnisë shqiptare njeh edhe gjendjen e mjerueshme të grues.<sup>17</sup>

Edhe e përkohshmja *Mësuesi* e drejtue me së pari prej Gaspër Mikelit e ma vonë prej Karl Gurakuqit do t’i kushtojë mjaft vemendje çeshtjes së grues në Shqipëri. Në një artikull redaksional me titull “Grueja” të numrit maj-qershor 1928, revista u drejtohet mësuesve tue theksue se s’mund të ketë edukim të shoqnisë pa edukue gratë, indiferenca ndaj tyne e mungesa e vemendjes asht tepër e damshme. Aty vihet në dukje sesi grueja duhet të jetë e zonja e shtëpisë dhe situata aktuale e saj nuk ia mundëson këtë gjë.<sup>18</sup>

Edhe Lumo Skendo fokusohet tek problemi i emancipimit të grues, tek një shkrim i gjatë me titull “Grueja”, ai mton me vu theksin tek nevoja e barazisë ontologjike mes burrit e grues, tue vu në dukjes se emancipimi i saj nuk mund të kufizohet vetëm tek heqja e çarçafit dhe e perçes, mbasi gra të pambulueme kemi, vëren ai, në Mirditë apo në Kurvelesh, por nuk janë të konsiderueme persona. Burri shqiptar ka turp me ia përmend emnin grues së tij, nuk flet kurrë për dashurinë për të dhe e trajton si skllave a si shërbëtore. Si në qytete si në fshatna ndryshe rritet biri e ndryshe bija, ndërsa katundari dhe maloku shpenzojnë ma shumë për shëndetin e lopës tek veterineri sesa për gruen tek doktori. Autori citon librin e njohun *La femme* të historianit Jules Michelet (1859), si edhe Ernest Legouvé, *Histoire*

16 *Mbleta*, shkurt 1922, n. 2, f. 23 vijim.

17 *Revista pedagogjike*, korrik-shtator 1924, nn. 7-9, ff. 559-563, 589-594, 610-615.

18 *Mësuesi*, maj-qershor 1928, nn. 9-10, ff. 279-286.

*morale des femmes*. Për Lumo Skendon kuptimi i të drejtave të grave s'mund të jetë një liri e pakontrollueme, zbatimje pa fre, dëfrime. Ideali i lirisë qëndron tek përmbushja e detyrës me përgjegjësi e ndërgjegje, tue qenë se gratë janë gjysma e njerzimit dhe s'u duhet mohue e drejta që ka çdo njeri që të zhvillohet moralisht dhe intelektualisht, të vendosë për shokun e jetës, të mos trajtohet si një gjasend. Ai sjell si shembuj pozitiv të trajtimit të grave Shën Mërinë, në traditën islame Hadixhenë, Fatimenë, e mandej Mesjetën kalorsiake deri tek hapat pozitivë që ban Revolucioni francez në shek. XVIII.

Feminizmi si lëvizje në botë ka ecë mjaft, vëren ai, por Shqipnia asht ende larg asaj mendësie e nuk ka nevojë me e ngjallë artificialisht, mbasi për gruen asht ma e preferueshme jeta e thjeshtë. Gjithsesi edhe për shqiptarët ka ardhë koha me dalë prej barbarisë dhe egërsisë së zakoneve të shëmtueme që cënojnë dinjitetin e grues.

Ajo që mton me theksue autori asht randësia e një emancipimi real, mbasi asht ma kollaj me mësue me kërcye *charleston* e *foxtrot* sesa me mësue shkrim e këndim dhe dituri shtëpiake. Nga ana tjetër ai pohon me një realizëm të pazakontë se "të jetuarit pabrenga" asht normale sot dhe ne s'do të mund ta ndalim! Por një moral i naltë ban që ajo lloj jete të mos përbajnë rrezik për femnën. E kanë gabim edhe njerëzit e fesë, vijon Lumo Skendo, kur mendojnë liria e grues sjell si pasojë indiferencën ndaj mësimeve të fesë. Frika e tyne nga modernizmi asht një frikë e kotë, mbasi aty ku s'ka qytetnim, inteligjencë dhe ideal s'mund te kuptohen as parimet e fesë.<sup>19</sup>

Ai përfundon: "A kujtoni se nderin dhe sedrën e gruas do ta ruajë ajo gjë karnavaleske që i thonë fereqhe në Gjinokastre apo xhybeja me dy minge të qepura prapa dhe me groteske akoma e Tiranësë".<sup>20</sup>

Shkrimi në fjalë do të vijojë në numrat e ardhshëm ku Lumo Skendo kundërshton ata që pohojnë se po të zbulohet grueja do të bahet e pandershme: *Për cilën grua e keni fjalën? Për gruan tuaj, keni lidhur jetën me një krijesë kaq të dyshimtë? Flisni kaq pa respekt për të? Nderi dhe sedra e gruas duhet bazuar tek besimi dhe jo mbi frikë të zingjirëve. Të mbajturit e gruas të kyçur në haremllek është një kujtim i mbetur prej kohëve barbare, dashuria është kondita e jetës, ajo lidh gjymtyrët e familjes. Pa dashuri nuk ka entuziazëm dhe as shpresë, ata që kanë turp të ndjejnë dashuri për tjetrin, turp t'ia zënë emrin gruas apo burrit nuk i kanë asnjërën.*

*Haremllek, selamllek, ahur* – filologjia na jep një mësim moral të çmueshëm, vetë kuptimi i këtyne skajeve përcakton sesi konceptohet grueja në shoqinë shqiptare: injorante dhe foshnjë.

Ideali ynë duhet të jetë naltsimi i saj intelektual, shpëtimi i saj prej një

19 *Mësuesi*, shtator-tetor 1928, nn. 1-2, f. 10.

20 Po aty, f. 12.

mendësie “përdhese”, këtu edhe grueja duhet të lëvizin, mbasi tue qenë për natyrë konservatore, ajo pajtohet me gjendjen e saj. Përkundër ajo duhet të qeverisin veten dhe të formojë një karakter të fortë, të pajiset me edukatë dhe me kulturë të nevojshme.<sup>21</sup>

Edhe në pjesën e tretë të shkrimit autori nënvizon randësinë e rolit të grues së emancipuese, “që pasanikët të mos ndryshojnë shumë prej paranikëve”, grueja duhet të riejnë fisin dhe fisnikërinë. Të lanunit mbas dore e edukatës dhe e arsimit të grues ka pengue mirërritjen e saj në shoqni. Për femnën shqiptare nevojitet një edukatë praktike në shërbim të funksionit social që ajo ka. Grueja duhet t’i jepet filantropisë, asistencës, pse nuk janë pasunia dhe xhevahiret që i japin dinjitet por shërbimi dhe përkushtimi i saj ndaj shoqnisë. Në këtë sens gratë e klasave të nalta duhet t’i shërbejnë popullit. Randësinë e emancipimit të grues e të kujdesit që shoqnia duhet të tregojë ndaj saj, autori e lidh edhe me zhdukjen e disa sëmundjeve si malarja, veremi, deformimet fizike etj.

Edhe në pjesën e fundit të shkrimit, Lumo Skendo sulmon mendësinë e mbrapambetun të shqiptarit, mbasi fatalizmi, javash javashi e inshallahu nuk janë rruga drejt përparimit, dembelia shpirtnore dhe mosnderimi i punës vetëm na pengojnë me dalë prej gjendjes së mjerueshme në të cilën jemi dhe përfundon: *nuk bëhet punë me dobi nëse gjysma e popullit, gruaja, rri indiferente përpara kësaj pune që duhet ndërmarrë.*<sup>22</sup>

Nji qasje tjetër gjejmë tek shkrimi me titull “Edukata fizike në shkollat femnore” i mësuesit të edukatës fizike Avni Zaimi, i botuem tek e përkohshmeja *Edukata e re* në vitin 1930.<sup>23</sup> Autori veçon Lycée Kyrias, Normalen e Korçës dhe shkollën e Stigmatineve në Shkodër për naltsimin e femnës dhe ven në dukje se pjesmarrja e femnave në sporte në Shqipni quhet krim. Ai shprehet me bindje se atletika ka një randësi të dorës së parë në formimin e elegancës së trupit femnor, mbasi marrja e femnës me sport i jep zemër asaj me luftue me natyrën, disiplina sportive e edukon me gjakftohtësi, prandaj intelektualët duhet ta mbështesin sportin për femna (f. 394).

Tek po e nejtja e përkohshme gjejmë shkrimin e H. Dokos: “Emancipacioni i gruas dhe edukacioni familjar” ku në thelb bahet një historik i origjinës së pabarazisë mes gjinive dhe i rolit të kulturës, Rilindjes europiane dhe Revolucionit francez në fitoren e të drejtave të grave. Autori tregon një erudicion të lavdërueshëm dhe mban një qëndrim të ekuilibruem ndaj raportit të të drejtave në një lëvizje feministe shqiptare. Tue përjashtue rrugën e ndërmarrun prej feminizmit amerikan, ai asht pro trajtimit të burrit dhe grues si qenje komplementare, bashkimi i të cilave duhet të sjellin harmoni, ashtu si edhe vetë intelektu dhe zemra krijojnë harmoni

21 *Mësuesi*, nandor 1928, n. 3, ff. 71-79.

22 *Mësuesi*, dhjetor 1928, n. 4, ff. 113-120.

23 *Edukata e re*, tetor 1930, n. 10, ff. 393-394.



tek secili individ.<sup>24</sup>

Në tetor të vitit 1929 sheh dritën e botimit *Shqiptarka*, organi i shoqnisë “Gruaja shqiptare”, e themeluar prej princeshës Senije Zogu në Tiranë. Qysh në numrin e parë gjejmë tre artikuj respektivisht prej Lumo Skendos (*Gruaja dhe jeta*, ff. 4-5), P. D. Kyrias (*Gruaja shqiptare*, ff. 5-9) dhe Afërdita Erbapi (*Shqiptarka e sotme*, ff. 16-17). Prania e pendave si Lumo Skendo dhe Parashqevi Qiriazi tregon se iniciativa “zyrtare” ishte marrë seriozisht në konsideratë prej intelektualëve të kohës. Prej numrit të dytë të saj, që ka drejtor-përgjegjes znj. Emine Toptani, gjejmë artikuj që mtojnë të hapin horizonte të reja, psh. rreth përparimit të grave në Kinë apo tema si ajo e përdorimit nga ana e grave të produkteve kozmetike. Ndër emnat që ndeshim tek kjo e përkohshme dhe sidomos tek shoqata që ajo përfaqson janë ato të Ikbal dhe Nebil Çikës, Ismihan Alizotit, Anna Pekmezit, Mehdi Frashërit, Emine Toptanit, Ikbal Beshirit, Qefser Tiranës, Kaliopi Plasarit, Kristina Tutulanit, Sarah Blloshmit, Kudret Delvinës etj. Në vitin 1929-1930 shoqnia ka të ardhuna prej 13 mijë fr.ar dhe asht e shtrime në të gjithë vendin me 20 degë të saj.

Edhe Mehdi Frashëri boton në janar të vitit 1929 shkrimin me titull “Gruaja Shqiptare dhe e Arthmeja e Shqipërisë”, ndërkaq revista del me titullin e ndryshuem: *Shqiptarja*, por herë-herë do të ketë luhate formash dhe pasaktësi të tjera në të dhanat bibliografike - si shumë të përkohshme tjera të asaj kohe. Politikani shqiptar thekson tek ky artikull se gjysma e popullsisë, nemos ma shumë, janë femna, tue përsëritë kështu argumentin e njohun sasior. Ai e sheh si përparim kufizimin mbas shpalljes së Pamvarsisë të poligamisë ndër sunitët shqiptarë, gja që ndër të krishtenë dhe bektashi ekzistonte edhe ma parë, pohon ai.<sup>25</sup> Parimi i barazisë mes burrit dhe grues asht simbas tij një fitore mbi poligaminë dhe heqja e çarçafit të grues asht një fitore tjetër. Fitorja e tretë do të jetë kur grueja shqiptare të mësojë në masë shkrim e këndim dhe mandej në fund edhe kultivimi i virtyteve qytetare dhe përfundon: “Në qyteterimin e sotëm populli më i lartë është ay popull që ka gratë më të larta nga të gjitha pikpamjet” (f. 75).

Po tek ai numër edhe Nebil Çika boton editorialin: “Gruaja moderne në Shqipëri dhe cilësitë që i duhen”<sup>26</sup>. Publicisti i njohun mendon se një grue e përgatitun për me krye misionin e saj duhet të zotnojë artin e të folunit dhe të shkruemit, të ketë një kulturë shkencore dhe të njohë gjuhët e hueja. Ai i jep një vend të randësishëm edhe ekonomisë shtëpiake, që e konsideron shkencë në vete: “shkenca e amvisërisë është arti i përdorimit të mirë të kohës, t’inteligjencës dhe të të hollave” (f. 77).

I gjithë ky modernizim pritet të vijë nga shkollat femnore të cilat sistemi

24 *Edukata e re*, tetor 1931, n. 10, ff. 275-277.

25 *Shqiptarja*, 30 kallnduer 1929, n. 4, f. 74.

26 Po aty, ff. 75-77.

zogist do të përpiqet t'i mbështesë.

Po ky autor disa muej ma vonë do të botojë artikullin: “Ç’kuptojmë nga “Gruaja Moderne”? Misioni i gruas është lumturia e kombit”, ku sqaron se qëllimi i shoqatës në fjalë asht modernizimi i grues shqiptare dhe përparimi moral i kombit.<sup>27</sup>

Edhe Terenc Toçi (Tocci) nën pseudonimin Milo Shini, do t'i kthehet temës së preferueme të çeshtjes feministe tek e përkohshmja *Shqiptarja*. Në vitin 1930 gjejmë një shkrim të tijin me titull “Shqiptarja e re. Problemi i parë”, ku kujton sesi në vitin 1920 revista *Agimi* preku pak çeshtjen e feminizmit, në një kohë kur “ajo bishë e egër që quhet opinjon publik ecte ende nëpër pyjet e pashqepuna të kohës së mjesme”.<sup>28</sup> Patrioti arbëresh kujton gjithashtu sesi në vitin 1923 pat përgatitë një projektligj për t'i dhanë të drejtën e votës grave të një shkalle kulturore të naltë, por mbasi ia dha për ta konsultue disa deputetëve të kohës, reagimet që pati ishin të gjitha negative. Ai pohon se nuk asht as për sufraxhetat por as për orientalizmat, por për një rrugë të mesme dhe citon G. Mazzini-n që shprehej se njerzimi asht një lis me dy degë: burri dhe grueja.<sup>29</sup> Toçi mendon me realizëm se problemi i grues “asht problemi ma i madh i Kombit, detyra ma e naltë, ma atdhetare e ma njerzore e qeverisë” e cila duhet të gjejë mjetet financiare e morale për me mbrojtë familjen.<sup>30</sup>

Edhe artikulli: “Drejtime për modernizimin e Femnës Shqiptare”<sup>31</sup>, i nënshkruem me inicialet A.J., pohon se “Grueja shqiptare ka ardhë koha që të njihet e mos të jetë shërbtore por shoqe shpirti e jo trupi, thesar i zemrës e jo vegël shtëpije”.<sup>32</sup>

Bahet fjalë për idenë të guximshme e shumë të përparueme për kohën edhe pse formimi i grues moderne shqiptare konceptohet në një kandvështrim naiv nëpërmjet letërsisë femnore, legjendave si ajo e Rozafës, rapsodive, të cilat rranjosin sensin e vetëmohimit, besnikisë dhe altruizmit tek ajo.<sup>33</sup>

Në qershor të vitit 1930 përfaqesuesja e shoqnisë “Grueja shqiptare” në Vjenë, dr. Anna Pekmezi, merr pjesë si delegate në Kongresin VIII ndërkombëtar të shoqnisë të grave që mbahet në kryeqytetin austriak nga 26 maji deri me 7 qershor të atij viti.<sup>34</sup> Në numrat e mavonshëm gjejmë

---

27 *Shqiptarka*, 15 dhjetor 1929, n. 3, ff. 49-51.

28 *Shqiptarja*, 12 mars 1930, n. 5, f. 99.

29 Po aty, f. 100.

30 Po aty.

31 *Shqiptarja*, 20 prill 1930, n. 6, ff. 122-123.

32 Po aty, f. 122.

33 Po aty, f. 123.

34 *Shqiptarja*, 30 qershor 1930, n. 7.

lajmin se znj. Emine Toptani merr pjesë në tetor të vitit 1930 si përfaqësuese e shoqnisë “Grueja shqiptare” në Konferencën Ballkanike në Athinë.

Edhe një personazh i njohun i jetës mondane të asaj kohe siç ishte Sarah Blloshmi, boton në këtë numër shkrimin “Feminisma dhe Shqiptareja” ku mbasi flet në mënyrë të përgjithshme për të drejtat e grues, përparimin e saj intelektual, moral dhe kulturor, hapë një temë të paprekun deri atëherë kur pohon se edhe në Shqipëri ka nevojë për të drejta politike të femnave e merr si shembull Francën laike e progresiste.<sup>35</sup> Me sa duket opinioni publik shqiptar po përgatitej gradualisht për ndryshime e mëdha që do të pasqyroheshin së shpejti edhe në legjislacionin e Mbretërisë zogiste.

Me të njëjtin regjistër komunikimi, por në kandvështrimin e pedagoges së impenjueme në shoqni, Sevasti K. Dako nënshkruen artikullin “Individualiteti i gruasë”, ku ven në dukje se aty ku grueja i ka fitue të drejtat e veta kjo gja ka ndodhë për tri arsye: 1) arsimit 2) idetë përparimtare dhe 3) zhvillimi fizik.<sup>36</sup> Për mësuesen e shkollës së vashave elementet e ekonomisë shtëpiake janë ma të randësishmit dhe profesionet tjera vijnë gjithnji mbas tyre, tue qenë se cilësia shtëpiake e një grueje asht *sine qua non* për të dhe për familjen.

Në këtë numër ndërhyjnë edhe Terenc Toçi, i cili ven në pah përparimin e grues në fashizëm, ku grueja merr pjesë në betejën e jetës dhe asht nënshtetase e mbretërisë. Pra, simbas revolucionarit arbëresh, që mbas pak vitesh do të përqafoje idetë fashiste, ideologjia në fjalë realizon gruen në rrafshin privat dhe në atë publik. “Feminizma e vërtetë – përfundon ai - kishte me u quejt njerzi: higjienë, disiplinë, punë, përpjekje legjislative, luftë së vjetrës, emancipim të grues”.<sup>37</sup>

Edhe juristi Kristo Floqi merr pjesë në diskutimin e hapun me artikullin “Gruaja shqiptare si bashkëshorte” ku nënvizon risitë e Kodit civil për përparimin e grues dhe mbron padyshim tezën e daljes së grave të zbulueme, pse grueja duhet të ketë liri e ta përdorin mirë atë, tue administrue shtëpinë e tue u tregue mike e përparimit dhe krahu i djathtë i burrit.<sup>38</sup>

Edhe gjatë vitit 1931 revista vijoi me qenë tribunë e mendimit emancipues të grues shqiptare. Aty gjejmë autorë të ndryshëm si Lumo Skëndo, Sevasti Dako, Ferit Vokopola, Dhimitër Beratti, Namik Delvina që shtrojnë probleme në lidhje me pozitën shoqnore të grues, reformat që duhen ndërmarrë, nevojën e ndërgjegjësimit të tyre dhe të naltësimit kulturor dhe moral.<sup>39</sup>

35 Po aty, f. 154. Artikulli i S. Blloshmit do të vijojë edhe në numrin mbasardhës, shih: *Shqiptarja*, 30 shtator 1930, n. 8, ff. 179-180.

36 *Shqiptarja*, 30 shtator 1930, n. 8, f. 170.

37 Po aty, f. 172.

38 *Shqiptarja*, 1 dhjetor 1930, n. 9, ff. 190-192.

39 Shih: *Shqiptarja*, fruer 1931, n.1, ff. 1-3; ff. 4-5; mars 1931, nn. 2-3, ff. 21-23; prill-maj

Kurse tek analiza e përciptë historike e Ferit Vokopolës, tek shkrimi me titull “Pozita sociale e grues”, veçojmë paragrafin e maposhtëm: “Duhet ta çmojmë si duhet zgjimin femnuer që përben gjysmën e kombit, të përpigëmi pa reshtur për t’u dhënë dritë e dituri vajzave tona që do të jenë memmat e e brezit të nesërmë; padyshim zgjimi e diturija e gruas do t’a arrinjë shqiptarizimën në kulmin e shkëlqyer të perparimit”.<sup>40</sup>

Ndërsa studiuesja britanike Margaret Hasluck tek shkrimi me titull: “Një mësim për gratë shqipëtare nga një grua angleze”, sjell përvojën e saj negative të mungesës së përgatitjes së grave shqiptare edhe në rastet ma elementare të sëmundjeve dhe lëvdon gjakftohtësinë e burrave shqiptare, të cilët – përfundon ajo – janë të zotët si infermieret angleze, kurse gratë shqiptare në rast sëmundje janë të pazonjat si burrat anglezë.<sup>41</sup>

Pjesa dërrmuese e shkrimeve të kësaj të përkohshme, tue përjashtue ato të Lumo Skendos e ndonji tjetri, nuk kanë ndonji spesor të veçantë sociologjik, u mungon trajtimi metodik dhe përgjithsisht janë rapsodikë, gjithsesi shihet se fryma e tyre asht funksionale e mtojnë me i shërbye konkretisht çështjes së emancipimit të grues.

Nji qasje disi ma specifike ka revista *Minerva* e Nebil dhe Ikbal Çikës, e cila përtej të qenit një revistë popullore pa pretendime shkencore, e trajton natyrshëm çështjen e feminizmit. Në këtë të revistë gjejmë shkrimin e iluminuem të Mehmet Konicës me titull “Problemi i garisë” i cili sjell me një paraqitje të shkurtë intervistën që grueja e shqueme indiane Begum Nourjehan Hysejn i jepte asokohe së përkohshmes *The Evening News* të Londrës. Konica thotë se edhe pse e kanë akuzue si konservator, ai e don përparimin por për të përparimi nuk asht me imitue të tjerët pa llogaritë se çka jemi e se çfarë vlerash dhe problemesh kemi ne vetë si popull.<sup>42</sup> Prej intervistës së Begum Nourjehan Hysejn merr shkas një shkrim me titullin “Mësimi që na jep vajza hindiane” i nënshkruem me inicialet B.H., ku autori flet për vizitën në Tiranë të znj. Bapsy Pavry, me të vëllanë dr. Jal Pavry, bijtë e kryetarit te komunitetit parsi në Bombay, të cilën erdhën në kryeqytet të veshun me rroba kombtare indiane dhe përfundon tue formulue pyetjen retorike: *po ne pse s’veshemi kështu?*<sup>43</sup>

Artikujt e Gaqo Gogos, i cili ka krye studimet në Institutin e Naltë të Edukatës fizike në Berlin, kanë për qëllim sensibilizimin opinionionit publik rreth randësisë së sportit për femnat. Tek shkrimi “Për një kulturë trupore femrore” ai vëren: “Insistojmë për tipin ideal të gruas, pse shkalla e lartë e qytetërimit të shpirtit në shoqëri s’mund të arrihet pa pasur gruaja atë vleftë

---

1931, nn. 4-5, ff. 37-40; gusht-shtator 1931, nn. 8-9, ff. 79-80.

40 *Shqiptarja*, prill-maj 1931, nn. 4-5, f. 44.

41 Po aty, ff. 52-53.

42 *Minerva*, 8 janar 1933, n. 6, f. 2 vijim.

43 *Minerva*, qershor-korrik 1934, nn. 21-22, ff. 15-16.

fizike e morale që ka ndër popujt e kulturuar”.<sup>44</sup> Ndërsa tek artikulli tjetër “Gra shtëpijake mos harroni trupin t’uaj!” boton një shkrim me ilustrime ku ven në dukje randësinë e gjimnastikës dhe kujdesin që femnat duhet të tregojnë për trupin e tyre në mënyrë që të jenë sa më të shëndetshme e të afta për misionin fisnik që kanë në shoqni.<sup>45</sup>

Tue marrë shkas prej një projektligji të paraqitur për miratim në parlament, i cili pengonte aksesin në disa nëpunësina të shtetit të personave të martuem me gra të hueja, Nebil Çika ironizon deputetin e Gjirokastrës Hiqmet Delvinën, promotor i asaj nisme qesharake që ndalonte martesën e të rinjve shqiptarë me shtetase të hueja. Duhet dijtë se zakonisht ishin ata intelektualë të sapolauruem jashtë shtetit që ktheheshin në atdhe së bashku me bashkëshortet e hueja dhe papritë e shihnin veten të përjashtuem prej një serie nëpunësish. Nebil Çika, i njohun për frymën e fortë polemike si publicist nuk i kursen sulmet *ad hominem* ndaj deputetit në fjalë, grueja e të cilit, vëren artikullshkruesi jep të holla me kamatë 20-30%, ndërkohë që ai vetë preokupohet për shtetësinë e grave të nëpunësave që kthehen prej jashtë shtetit. Ky ligj dashka me ndihmë vajzat shqiptare, pyet Çika, por pse nuk e pyesim veten se çka kërkojnë të rinjtë shqiptarë që martohen me të hueja! Ata, vijon ai, kërkojnë ato cilsina që nuk i gjejnë tek grueja shqiptare: *charme, coquetteri*, sensibilitet, kulturë. Çfarë dami sjellin ato martesat? Po të mira a sjellin? Publicisti len me kuptue se ato vajza të reja që vijnë me jetue në atdheun tonë sjellin me vete një frymë të re e një shembull emancipues për shqiptarët dhe përfundon tue vërejt se ai ligj ka plagosë të rinjtë në intimitetin e jetës së tyre e i ban thirrje politikës të krijojë një atmosferë rritjeje që i përshtatet kohës së vajzave tona e të mos miratojë ligje të tilla penalizuese për ajkën e intelektualëve të rinj.<sup>46</sup>

Krejt të tjerë regjistra përdorë revista me tendenca të majta *Bota e Re* që botohej në Korçë në gjysmën e dytë të viteve ’30. Fryma politike e kërkesave për emancipimin e grues si edhe një lloj padurimi në rrugën e reformave që ndërkaq kishin nisë, karakterizojnë shkrimet e shpeshta rreth kësaj teme që gjejmë tek kjo e përkohshme.

Në shkrimin me titull “Problemi i gruas” i nënshkruem nga Ola Jani, autorja vëren se problemi nuk zgjidhet me llafe por me lëvizje të gjalla dhe se nuk asht shetitja në bulevard apo shenjat e jashtme të qytetnimit oksidental ato që i mjaftojnë grues shqiptare, por ndryshimet rranjësore dhe barra ma e randë i takon arsimtares së qytetit, mbasi tek ajo mvaren shpresat e emancipimit te gruas.<sup>47</sup>

Ndërsa shkrimi “Modernizma dhe çarçafi” i nënshkruem me pseudo-

44 *Minerva*, 15 shtator 1933, n. 14, f. 13.

45 *Minerva*, 25 dhjetor 1934, n. 26, ff. 6-7.

46 Nebil Çika, Pse s’martohen me vajzat e vendit?, *Minerva*, 2 mars 1934, n. 18, ff. 18-19.

47 *Bota e Re*, 15 maj 1936, n. 3, ff. 8-9.

nimin Harbuti nga Selim Shpuza, asht një polemikë me organin zyrtar të bashkësisë islame *Zani i Naltë* për çështjen e mbulimit të grave. I njëjti artikullshkrues kishte kërkuar tek një shkrim i maparshëm me titull “Shkolla borgjeze-okcidentale...” ku paraqiste nevojën e oksidentalizimit të elementit muhamedan dhe sidomos zbulimin e grues myslimane. Këto kërkesa hidhen poshtë me indinjatë nga e përkohshmja islame e cila sjell si kundërgjegjësi faktin që grueja malsore shqiptare edhe pse e zbulueme nuk njihet asnjë përparim dhe se Hitleri në Gjermani ua ka ndaluar grave pjesëmarrjen në jetën publike. Harbuti thekson se asht i pasaktë pohimi se Hitleri i ka mbyllë gratë, ndërsa do të mjaftonte me pa lëvizjen emancipuese të nisur prej Riza Shahut apo Kemal Atatürkut në favor të grues. Gjithashtu nuk i duket korrekte marrja si shembull e grues malsore katolike të zonave të mbrapambetuna malore, kur mund të kihej parasysh – thekson autori – grueja katolike shkodrane apo ajo ortodokse korçare që janë pararojë e emancipimit. Autori përfundon tue vërejt se çarçafi duhet zhdukë pse asht çnjerzor, pengon zhvillimin e elementit muhamedan, forcon konservatorizmin ndër të krishtenët, pengon zhvillimin e katundit, na turpnon në sy të huejve dhe nuk i përshtatet pozitës sonë gjeografike.<sup>48</sup>

Një autor tjetër me pseudonimin Hajdel nënshkruen një seri artikujsh rreth çështjes së grues. Tek njëri sish me titull “Martesa: tregëti”, ai merret me natyrën e kontratës martesore e cila nuk i përmbush në kushtet shqiptare qëllimin e saj të naltë por asht një zgjedhje e ligjshme e grues. Degjenerimi i natyrës së kësaj kontrate vërehet kur ajo pranohet nën ndikimin e kushteve materiale dhe kthehet në ferr tue krijue vuetje dhe imoralitet.<sup>49</sup> Edhe tek shkrimi tjetër “Për gruan” ai vëren gjendjen e mjerë të grues, tue nënvizue se çdo mvarësi shoqërore rrjedh nga mvarësia ekonomike.<sup>50</sup> Tek vijimi i këtij artikulli, me titull “Për gruan”, Hajdel mton me rindërtue historikisht kalimin nga matriarkati tek patriarkati. E kotë me shtue këtu se analiza e përmbledhun në atë pak rreshta asht e dënueme me qenë sipërfaqësore dhe e paefektshme.<sup>51</sup>

Një pendë e pranishme në shtypin e kohës që tregon ndjeshmëni ndaj çështjes së grues asht edhe ajo e Selfixhe Ciut, e cila nënshkruente me pseudonimin Kolombja. Tek një shkrim me titullin: “Asgjë nga femra, pa i falur lirinë e saj të plotë”, ndjeti i mirë i intelektualës së re progresiste përzihet me tonet patetike dhe pyetjet retorike rreth ekzistencës së femnës

48 *Bota e Re*, 15 korrik 1936, n. 7, ff. 5-9.

49 *Bota e Re*, 15 gusht 1936, n. 9, ff. 9-10.

50 *Bota e Re*, 15 shtator 1936, n. 11, ff. 9-11.

51 *Bota e Re*, 30 shtator 1936, n. 12, ff. 17-18. Artikulli vijon edhe në numrin e datës 15 tetor 1936, n. 13, ff. 3-5, ku analiza historike e kritike përfshin konceptin e grues në Bibël, në Mesjetë e deri tek lëvizja e Revolucionit francez.

në shoqni, fatit të saj të keq dhe të qenit në shenjës.<sup>52</sup>

Nji autore që dallohet tek *Bota e Re* asht edhe Mila Gjakoreci e cila polemizon me artikullin e Hajdel "Martesa tregëti", tue vërejt se nga gjendja e beqarisë me atë të qenit e martueme, femna këmben autoritetin e prindve me atë të burrit, tue mbetë gjithnji nji qenje inferiore. Në këto kushte nji burrë që e don të nënshtrueme nuk mund të ketë të drejtë me mtue prej saj afinitet intelektual dhe moral! Ndërsa në nji anë mashkulli arrin moshën madhore me gjithë prerogativat që ajo ofron, femna mbetë gjithë jetën në gjendjen e mitunisë, vëren Gjakoreci me tone iluministe. Femna, shton ajo, duhet të zhvillojë intelektin e saj, pamvarsinë ekonomike, ndërsa martesa duhet të qëndrojë në rend të dytë, edhe pse vetëm nepërmjet saj duhet të realizohet bashkimi seksual, edhe për mashkullin, dhe jo ato "institute antinjerzore që edhe sot po përkrahen nga shoqëria njerëzore. Sepse në ato hekatombe të turpëshme, për qefin e një pjese njerëzimit, po koruptohen dhe po sakrifikohen qënjet e mjera njerëzore" - përfundon ajo tue polemizue me diskutimin e hapun asokohe rreth funksionit social të prostitucionit.<sup>53</sup> Po kjo autore merr pjesë në debatin rreth gjendjes së femnës edhe me artikullin: "Situata e sotshme e femrës shqipëtare" ku vëren se pa vetëdije s'mund të ketë emancipim dhe pa këtë nuk ka përparim shoqnor dhe ekonomik, ndërsa roli i femnës duhet t'i kalojë kufijtë e votrës shtëpiake tue u ba faktor edhe në lëvizjet e ndryshme shoqnore.<sup>54</sup>

Tek artikulli "Hallet e gruas shqiptare", Gjakoreci shënjestron konservatorizmin e palogjikshëm të mashkullit shqiptar, sidomos kur fjalëve të bukura në dukje i pasojnë sjellje të mbrapambetuna e nji mentalitet i gabuem. Aktivitetin e shoqnisë "Gruaja Shqiptare" ajo e quen nji "dritë e zbehtë" dhe pyet se çka ka ba konkretisht kjo shoqni për zbulimin e grues myslimane apo për zhvillimin fizik të femnës shqiptare. Autorja shprehet se nuk shkruen për detyrat e shenjta të grues por për të drejtat e saja dhe se këto nuk qëndrojnë tek makiazhi, veshja apo stolisja por te zhvillimi i atyne cilësive që ndikojnë pozitivisht për krijimin e kushteve pozitive për nji jetë të lumtun për seksin e shtypun, e domethanë: logjika, kultura dhe karakteri i fortë.<sup>55</sup>

Muejt e fundit të vitit 1936 janë plot tharme pozitive në shtyllat e revistës *Bota e Re*. Tajar Zavalani në sintoni me nismat shtetnore të kohës boton shkrimin: "Ferexheja dhe qytetërimi", ku në polemikë me revistën *Zani i Naltë* citon madje edhe Naim Frashërin: "Ndalim i math në përparimin e një kombi! Si mund të vejë mbroth një komb kur gratë, domethënë gjysma e njerëzisë rron e mbyllur si në kuvli? (...) Gruaja është mëm' e fëmijës,

52 *Bota e Re*, 15 shtator 1936, n. 11, ff. 7-8.

53 *Bota e Re*, 30 shtator 1936, n. 12, ff. 5-7.

54 *Bota e Re*, 30 tetor 1936, n. 14, ff. 3-4.

55 *Bota e Re*, 15 shkurt 1937, n. 21, ff. 3-5.

zonj' e shtëpisë dhe krej i njerëzisë".<sup>56</sup>

Nji publiciste aktive tek revista korçare asht edhe Ollga Plumbi, e cila padyshim asht penda ma e thellë, njohëse dhe premtuese e zgjidhjes së arsyeshme të problemeve të grues shqiptare të kohës. Tek shkrimi: "Problemi i gruas pa mbrojtës" ajo merr shkas prej një konference të grues në Dubrovnik, ku kishin marrë pjesë 200 përfaqesuese të vendeve të ndryshme dhe ishte hjedhë propozimi që sigurimet shoqnore t'u paguenin grave fatkëqija një pension si shpërblim. Artikullshkruesja sugjeron që vetë jeta e grues së martueme të konsiderohet si një profesion dhe ajo të vlerësohet e të përkrahet ekonomikisht për atë çka ban në shtëpi.<sup>57</sup>

Tek artikulli "Kush asht fajtori?", Ollga Plumbi shprehet se edhe vetë grueja asht fajtoare për gjendjen e saj, mbasi ajo bindet se natyra ka qenë e padrejtë me të. Pashirrmat "le të isha burrë" tregojnë dëshpërim dhe dobësi, mbasi ajo s' duhet të jetë burrë por duhet të naltësojë vetveten.

Simbas Plumbit nuk asht natyra fajtorja e problemeve kësisoji, por vetëm edukata dhe kultura e gabueme, tue qenë se vetë nana e nis nderimin për mashkullin qysh në djep dhe s'e mbaron kurrë, nuk mjafton as arsimi për këtë padrejtësi, së bashku me arsimin duhet dhanë edhe një edukatë me frymë drejtësie. Ajo asht e bindun se lumtunia familjare dhe harmonia shoqnore burojnë prej së vërtetës dhe drejtësisë.<sup>58</sup>

Tek shkrimi tjetër: "Gruaja si amvisë, si bashkëshorte dhe si nënë", Plumbi përpiket me zhba paragjykimin e rranjosun thellë se grueja e padijtun asht një amvisë ma e mirë se ajo e shkolluemja. Për të grueja e dijtun asht një ekonomë ma e mirë, nuk i frikësohet vështirsinave dhe nuk pranon imponimin në mbarështrimin e shtëpisë, ajo ka një epërsi morale mbi joshjen e luksit, kurse grueja e padijtun s'asht as e zonja e vetes e kah ana tjetër ia përçon fëmijëve injorancën e saj.<sup>59</sup>

Viti 1937 i kësaj reviste hapet me një artikull interesant të Muzaffer Pipës me titull: "Gjendja e grues në Shqipni", ku mbasi vërehet me pesimizëm se përparimi i femnën në Shqipni asht i padukshëm, citohet edhe Gorki kur thotë se në prehën të nanave trajtohen kombet. Pipa thekson se rreziku i fanatizmit asht 360 gradë. Simbas tij korrupsioni femnor në Shqipni, e tregues janë sëmundjet e flligshta që janë përhapë, asht i naltë. Kah ana tjetër numri i femnave asht në ulje e përsa i përket emancipimit të grues duhet të marrim shembull prej Turqisë, kushtet në cilat ajo lëvizje asht zhvillue janë të ngjashme me tonat. Gratë tona, vëren avokati shkodranë, nuk kuptojnë letërsi, nuk ndigojnë muzikë, nuk njohin artin, nuk ushtrojnë sportin. Ato janë anemike e të dobta fizikisht, të shëmtueme

56 *Bota e Re*, 30 tetor 1936, n. 14, f. 3.

57 *Bota e Re*, 30 nëntor 1936, n. 16, ff. 6-7.

58 *Bota e Re*, 15 dhjetor 1936, n. 17, ff. 1-3.

59 *Bota e Re*, 30 janar 1937, n. 20, ff. 5-6.



e të zhgatrrueme; punojnë në shtëpi por s'kanë një rregull pune, s'kanë rregull ushqimi e jetese, janë qesharake me brandavekë e me çarçafa e me ferexhe. Kurse katoliket shkodrane me çarçafa e me një sy jashtë e një të mbuluem janë po aq qesharake sa edhe tjerat. Që gjendja e grues nuk asht e mirë e tregojnë edhe shkunorzimet për mospërputhje karakteri, për grindje në familje etj. Ajo që nevojitet asht barazia shoqnore, krijimi i personalitetit të grues, njohja e të drejtave të saja morale e fizike, liria e saj. Nga ana tjetër, formalisht në Shqipni, vëren ai, femna ka të gjitha të drejtat e burrit, përjashtoj shërbimin ushtarak (*sic*) dhe të drejtën e votës. Pipa nuk mton me e nxjerrë femnën jashtë folesë shtëpiake, por asht i bindun se ajo duhet të thellohet e të kuptojë se çka asht ekonomia shtëpiake, higjiena, në mënyrë që të rrisin fëmijë të vlefshëm për kombin. Nga ana tjetër malsoret e katundaret janë thjesht skllave e jetojnë në mjerim, tue qenë të mundueme ma keq se shtazët e kur ndonjena gjen guximin me ikë, atëherë nisin vrasjet mes fiseve. Kësaj gjendje i duhet gjetë shpëtimi: "E i vetmi mjet shpëtimi asht kultura dhe guximi i mprojtjes dhe i daljes zot vet-vehtes".<sup>60</sup>

Autori kërkon një reformë të re efikase e i drejtohet bashkëqytetarëve të tij: merrni shembull nga Korça, ku turma vajzash shkojnë në shkollë të përzieme, pa çarçafa, pse duhet të dalin në shesh balli i racës shqiptare, dhe përfundon: "E pra, ti vashë fillo: Duhet formim e evoluim: Fillo e hiqe çarçafin pa kenë nevoja me të detyrue, me t'a shkye e me t'a coptue kush. Mandej, me baza të shëndoshta, me parime të kjarta, me moral të pastër, me ndërgegje të kulluet e me sqetësi të shqueme, ban qi t'i a mbriresh fazës civilistike të matun, të përshtatun dhe të dejë për gruen Shqyptare".<sup>61</sup>

Edhe revista popullore shkodrane *Cirka* e drejtueme në fundin e viteve '30 prej Cuk Simonit, i jep hapsinë çështjes së emancipimit të grues. Koordinatat botëkuptimore janë ato të një mendësie perëndimore të frymzueme prej parimesh të krishtena, ndërsa forma asht bashkimitare, tue shmangë përplasjet si me besimet tjera ashtu edhe me politikën.

Shkrimi me titull: "Edukata e grues" i nënshkruem me pseudonimin Z-eta, parashtron idenë se grueja ka një raport të thellë me familjen dhe me kombin, ajo madje asht në shërbim të kombit, kështu që një nanë atdhetare rritë fëmijë atdhedashës. Kurse fakti që grueja s'i njej të drejtat e saja asht një faj që i randon shoqnisë së cilës ajo i përket. Rrugëdalja naive shihet tek krijimi i qendrave të edukimit për gra, pjesmarrja e tyne e detyrueshme në shoqnia me qëllime emancipuese, ku atyne t'u jepet një edukatë mendore dhe shpirtnore me frymë kombtare.<sup>62</sup>

Në numrin e datës 6 qershor 1937 *Cirka* përcjell lajmin se në Shkodër

60 *Bota e Re*, 15 janar 1937, n. 19, f. 9.

61 *Po aty*, f. 10.

62 *Cirka*, 9 maj 1937, nn. 20-21, ff. 82, 84.

me datën 26 maj 1937, në sallonin e shoqnisë Vllaznia u themelue dega e shoqnisë Grueja Shqiptare, ku fjalën përhëndetëse e mbajti Luçija Zef Kurti ndërsa kryetare e degës u zgjodh zonja Ikbal Hurshiti, bashkëshortja e prefektit të Shkodrës.

Nji shkrim redaksional i nënshkruem Lupi, me titullin “Çashtja femnore”, mbasi nis me devizën se “grueja asht faktori ma i parë i gjytetnimit të nji populli”, analizon randësinë e mendësisë që sjellin në atdhe të rinjtë që studiojnë jashtë atdheut. Mjerisht ata që jo vetëm nuk janë thellue në studime por kanë marrë veç “leskra kulture” dhe shije të dyshimta, kur kthehen në atdhe ndikojnë për keq tek vajzat shqiptare, në nji kohë që vendi ynë nuk ka nevojë për kuklla oksidentale por për gra që t’u shtijnë fëmijëve në zemër ideale të nalta për punë të mira e të mbara për vendin e tyne.<sup>63</sup>

Penda ma e randësishme femnore që gjejmë në shtyllat e kësaj të përkohshme asht ajo që nënshkruen me pseudonimin *Parva favilla*, përçuese e nji mendësie të moderueme e deri diku edhe konservatore. Tek artikulli “Misioni i grues”, ajo shprehet çuditshëm se feminizmi asht konsumue si ide dhe se madje dalja e grues në zyra e puna e saj në fabrika janë shkaqet e papunësisë që vërehet në botë. Simbas saj Perëndia e natyra e kanë ba gruen ndryshe prej burrit, tue e caktue për funksione të ndryshme. Grueja asht shoqja e burrit, jo zotnuese e as robneshë e tij, ajo asht përkrahësja dhe ndihmësja e tij e tij, e ky asht misioni i saj. Burri asht koka, ndërsa grueja asht zemra e kjo s’asht ba me u marrë me politikë e me qenë faktor në jetën publike por me ndikue nepërmjet burrit në jetën publike, mbasi ajo mbetë parësisht shoqe jetet e tija dhe nanë e fëmijëve.<sup>64</sup>

Tek shkrimi: “Grueja shqyptare e ardhmenija e kombit”, shkruet me rastin e 25-vjetorit të Pamvarsisë, autorja kremton vetitë e grues e nanës shqiptare, e cila cilësohet si “ushtari i madh i panjoftun i luftës dhe i ides kombtare”, faktori i qindresës së popullit tonë ndër shekuj. Pjesës lavdruese i pason ajo qortuese ku vehet në dukje sesi gratë e vajzat po thithin veset e mbrapshta, doket e flashkëta, ndër ta po mbizotnon ideali me ia ndie lezetin jetës, gjana këto, simbas opinionit të artikullshkrueses, që bajnë të marrim teposhtën si komb. Për të gjendja ekonomike nuk asht parësore, mbasi në të kaluemen edhe pse në kushte shumë ma të vështira grueja shqiptare ka mbërrijtë me ba shumë ma tepër për kombin tonë.<sup>65</sup>

Po e njehta pendë tek artikulli me titull: “Problemi i Dashtnís” thekson me nji frymë augustiniane se e vetmja gja e pranueshme asht ajo që përmblihdhet nën konceptin e vërtetë të dashunis, gjithçka tjetër asht egoizëm i maskuem. Simbas saj dashunia e vërtetë çon në bashkimin e dy

63 *Cirka*, 19 shtator 1937, n. 30, ff. 238-239.

64 *Cirka*, 3 tetor 1937, n. 31, f. 249. Shih: *Cirka*, 17 tetuer 1937, n. 32, f. 268.

65 *Cirka*, 26 dhetuer 1937, nn. 35-36, ff. 325-328.

jetëve me ndërtue një familje e me përjetësue farën njerzore, prandaj çdo gjë që then dashurin e votrës familjare, then rendin e natyrës, veprim i cili sjell me vete konsekuenca të mjerueshme. Simbas saj divorci asht një e keqe e legalizuese, por fajtor për atë cak nuk janë vetëm burrat por edhe gratë të cilat duhet të udhëheqin djelmnin në hullinë e dashunisë së vërtetë. Mbi ne – përfundon ajo - rondon barra e madhe me e mbajtë të papërlueme traditën e lumnueshme të grues shqiptare.<sup>66</sup>

Përposë idealizimit të figurës së grues shqiptare dhe disa udhëzimeve të frymzueme sa nga besimi sa nga logjika e shëndoshë, nuk gjejmë në këto artikuj një ide praktike të qartë që të mund të ndihmonte lexueset e asaj kohe për me ndërmarrë hapa konkrete për një ndryshim rranjësor të gjendjes.

Edhe në faqet e *Përpyjekjes shqiptare* të Branko Merxhanit në fund të viteve '30 ndihet tharmi i diskutimit reformator për gjendjen e grues në Shqipëri.

Me tone të forta luftarake dhe me inteligjencë asht shkruar edhe artikulli i Ollga Plumbit, i botuar tek kjo revistë, me titull: "Feminizmi dhe shoqëria e jonë". Publicistja e afirmueme nxjerr në pah faktin se grueja shqiptare asht pasive, nuk merr pjesë në lëvizjen feministe për emancipimin e saj. Prandaj kanë të drejtë ata që thonë se fitoret e saja ia ka dhanë burri, për shembull Kodi Civil i cili e vendosë gruen shqiptare në një rradhë me gratë e vendeve të qytetnueme, megjithëse ajo vetë nuk i njeh aspak të drejtat që ka. Deri në një kohë edhe në botë mendonin se emancipimi i grues do të sillte me vete shkatërrimin e familjes dhe të shoqërisë, sot le të nxjerrim mësim nga lëvizja feministe botnore e mos të kemi frikë të paarsyeshme rreth liritimit të grues prej vargojve të padrejtësive.

Plumbi analizon lëvizjen feministe në botë, shkaqet njerzore të qytetnimit, ato psikologjike dhe ekonomike, tue i krahasue me mendësinë shqiptare ku grueja intelektuale ose puntore shihet si fenomen anormal dhe shkatërrues i familjes.<sup>67</sup>

Simbas saj "feminizmi i ndritur e i thjeshtë" e don lumtuninë e familjes, e cila nuk ekziston kur gruaja nuk e vendosë në altarin e asaj lumtunije kapitalin e vleftës së saj, fuqinë e saj shpirtnore e mendore: "Qëllimi i Feminizmit është të na ngrejë mentalisht aqë sa të na imponohet dëshira të kërkojmë një tjetër tip familjeje. Atë ku të dy bashkëshortët të matin lartësin e misionit të tyre dhe madhësin e përgjegjësis kur e themelojnë. (...) Feminizmi, duke njojtur rëndësin që ka familja për përparimin njerëzor, do që t'i japë fuqi të reja. Dhe fillon atë qëllim nga themeli i familjes: Gruaja".<sup>68</sup>

Po kjo publiciste stigmatizon tek shkrimi "Gruaja, viktimë e fatit",

66 *Cirka*, 13 fruer 1938, n. 39, f. 4.

67 *Përpyjekja shqiptare*, prill 1938, n. 16, f. 179.

68 Po aty.

faktin që edhe kur prindt i kanë mundësitë ekonomike dhe shpenzojnë për vajzat e tyre, në fund qëllimi i gjithë atij shpenzim asht jeta mondana, pra: martesë, gjetja e një fati të mirë, pse të gjithë besojnë se vetëm prej saj mvaret lumtunia njerzore. Megjithatë: “Nuk mund të quhet lumtëri për një vajzë kur vjen në moshë t’ua ndjejë vehten e saj si plaçke për të shitur, ose si një vepër artistike për ekspozuar. Konditat e ra të jetës së gruas kërkojnë që ajo të jetojë e qeverisur prej urtësis dhe e forcuar prej vullnetit të vet”.<sup>69</sup>

Menjherë autorja merret me ata që kanë dyshime rreth ndikimit që mund të ketë në jetën e grues zhvillimi i saj intelektual, konservatorët mendojnë se kur grueja lirohet prej kufizimeve ekonomike e shoqnore nuk asht moralisht e qëndrueshme në jetë. Këtyne Plumbi iu përgjegjet se edhe sikur grueja t’i hjedhë mënjane disa rregulla morale ajo ka veti me krijue rregulla të reja, aspak inferiore, madje ma të nalta se ato që shekujt i kanë tërheqë zvarrë deri më sot dhe që nuk kanë asnjë bazë racionale.<sup>70</sup>

Edhe pedagogu i mirënjohun i kulturës fizike Gaqo Gogo boton një shkrim me titullin: “Gjëndja fizike e femrës shqiptare” ku ankohet për gjendjen fizike të mjerueshme të femnës, për deformimet e saja skeletore, sëmundjet, zakonet e këqija që ndikojnë në mënyrën e të ushqyemit dhe në jetën e përditshme të saj, përfshi edhe oraret. Nga ana tjetër, vijon ai, vajzat nuk losin, nuk shetisin, rrijnë gjithë kohën mbyllë, të ndryeme, pa ba aktivitet fizik e madje as në shkolla nuk ka programe me ushtrime fizike. Ka mandej prej atyne femnave që mendojnë se bajnë sport tue kërcye atë “dancin epileptik charleston”, pohon autori. Nga ana tjetër ai nxjerr në pah faktorët që ndikojnë pozitivisht si ajri dhe dielli, veshja e përshtatshme, higjiena etj. Simbas Gogos detyra e promovimit të sporteve dhe të aktivitetit fizik ndër femnat shqiptare i takon sa shkollës dhe sa shoqnisë “Gruaja Shqiptare”.<sup>71</sup>

Kemi ardhë kështu në fundin e viteve ’30. Pranvera e vitit 1937 ka sjellë me vete një seri të rejash pozitive në panoramën politike të kohës përse i përket çështjes së grues, kështu që vetë drejtori i së përkohshmes boton artikullin: “Problemi i grues” ku përshëndetë vendimin e Këshillit të Përhershëm të Komunitetit Mysliman për zbulimin e fytyrës së grues myslimane dhe tonet pranuese ndaj këtij akti që vërehen tek revista *Zani i Naltë*. Megjithatë, shton autori, nuk mjafton zbulimi i grues, pse problemi i grues asht pjesë e problematikës së shoqnisë sonë, asht çështje kulture dhe edukate, prandaj duhet krijue një institucion që të studiojë fenomenet shoqnore ku ban pjesë edhe grueja.<sup>72</sup>

69 *Përpyekja shqiptare*, maj 1938, n. 17, f. 260.

70 Po aty.

71 *Përpyekja shqiptare*, dhjetor 1936, n. 3, ff. 163-166.

72 *Përpyekja shqiptare*, prill 1937, n. 3, ff. 46-48. Në vitet 1942-'44 edhe revista *Njeriu*, organ fetar mysliman e themelueme prej Ferit Vokopolës, trajtoi çështjen e grues me

## Përfundim

Nuk ishte qëllim i kësaj panoramike mbi historikun e feminizmit në shoqinë tonë, evidentimi dhe shterri i të gjitha materialeve që pasqyrojnë këtë rrymë në shtypin shqiptar të kohës dhe në arkiva, pse do të duhej të kishim përmendë fillimisht ndoshta të parën shoqatë të femnave në Shqipëri: “Ylli i Mëngjesit” të Korçës të vitit 1912. Ajo që jemi përpjekë me gjurmue në këtë shkrim asht vijueshmëria e pranisë së instancave feministe në shoqinë shqiptare - tue nisë shi prej vitit 1920, prej atij momentit politik thelbësor të konsolidimit të shtetit shqiptar.

Së dyti, qëllimisht, aty ku historiografia e kohës së komunizmit për arsye të mirëfillta ideologjike ka folë thjeshtë për “lëvizje femërore të grave” apo për “emancipim”, a thue se çeshtja në fjalë ishte e fundit gjë që kishte mbetë pa u realizue asokohe, ne kemi preferue me e pa atë në optikën e një feminizmi të përmbajtur, pra, të një lëvizje ku identifikohen qartësisht elementat bazë të valës së parë të feminizmit botnor.

Nji pjesë e madhe e shkrimeve që kemi analizue rrezatojnë idealet feministe të kuptueme si pjesë e një filozofie praktike. Burimet e drejtpërdrejta frymzuese herë janë idealet e Rilindjes kombtare, herë ato të iluminizmit francez apo të Turqisë kemaliste. Nga ana e botëkuptimit apo edhe e ideologjisë frymzimi në fjalë luhetet nga fryma e krishtënë tek ajo e majtë marksiste.

Në vitet '20, por edhe ma vonë, feminizmi shqiptar nuk ka karakter politik por vetëm shoqnor, pothuajse të gjithë janë të bindun se grueja e ka vendin mbrenda katër mureve të shtëpisë, prandaj edhe argumenti që përshkon natyrshëm rrymat e ndryshme asht ai sasior: grueja përban gjysmën e popullsisë dhe s’duhet neglizhue gjendja e saj, mbasi emancipimi i grues asht njikohsisht përparim moral i kombit. Kjo tezë e rilindasve ka shumë ndikim dhe asht madje ma bindëse se teoritë e ndërlikueme të matriarkatit apo historiku i fitoreve që e kanë zanafillën tek Revolucioni francez, mbasi kur bahet fjalë për të mirën e kombit edhe forcat ma të mbrapambetun nga ana shoqnore e kulturore stepen dhe lëshojnë pe. Po këto forca shprehin herë mbas here dyshimin se mos po ngjallet nji debat artificial në hullinë e asaj ndërkaq po ndodhte nëpër botë, dhe imitimi i botës perëndimore për ta nuk shihej si nji zgjidhje e mirë për kushtet shqiptare. Kundërargumenti ishte se edhe Turqia kemaliste, vend ndaj të cilit nji pjesë jo e vogël e dyshimtarëve të progresit kishte dobësi të thellë, po përqafonte me sukses këto ndryshime.

Nga ana tjetër pjesa përparimtare për me krijue idenë e universalitetit të lëvizjes feministe nuk ngurronte me sjellë shembuj deri edhe nga Kina,

---

anën e disa shkrimeve të nënshkrueme me pseudonimin “Madeleine”. Shih. *Njeriu*, 1942, n. 6, f. 9; 1943, n. 9, f. 6; 1944, n. 7, ff. 5-6.

India apo Japonia e largët. Pra, edhe argumenti gjeografik shihet si i dobishëm për mendësinë e mbyllun të shqiptarit të asaj kohe.

Nji risi në vete përban përpjekja me ngjallë një lëvizje sportive femnore dhe së fundi ideja me themelue një institut studimesh sociologjike që të hulumentonte dinamikat e randësishme prej të cilave duhej formulue një zgjidhje realiste për çështjen e emancipimit të grues.

Fakti që tue nisë prej viteve '20 e deri në gjysmën e viteve '40 një pjesë e konsiderueshme e publicistave dhe publicisteve që shkruajnë për çështjen e feminizmit dhe atë të emancipimit të grues, përdorin pseudonime, tregon se gjendja e përgjithshme shoqnore në të cilën po zhvillohej kjo lëvizje ishte problematike, t'paktën përse i përket nivelit të përgjithshëm të opinionit publik.

Nuk jemi marrë me lëvizjen radikale në favor të grues që merr hov me ardhjen e komunistave në pushtet. Bahet fjalë për një kapitull në vedit që zhvillohet në një suazë ideologjike ku forca e vendimeve partiake përbuzë çdo të drejtë njerzore, gja që nuk jep fryte të qëndrueshme dhe rezultate të thella, me gjithë larminë e mjeteve në dispozicion, nga bindja tek dhuna, nga e vërteta historike tek shtrembnimi i saj i pastër.

Grueja në komunizëm në një anë fiton shumë të drejta, për të cilat shoqnia kishte 30-vjet që diskutonte me debate të mprehta, por njëkohsisht ajo tjetërsohet mbasi mbi të shkarkohet e plotë barra e dyfishtë e të qenit në shërbim të burrit dhe në shërbim të Partisë-Shtet. Kjo gja sjell braktisjen e disa prerogativave themelore që lidhen me edukimin e fëmijëve, gja që i kalon pjesërisht Shtetit. Emancipimi komunist e ekspozon gruen ndaj detyrimeve si puna me turne, aksionet, zboret, transferimet e detyrueshme, në një kohë që puna e saj shpërblehet gjithnjë me një pagë ma të ulët se burri. Në familje ajo vijon me qenë subjekt i burrit, një subjekt dyfish i shfrytzuem që prodhon të ardhuna por asht ende larg prej të qenit e pamvarun. Sado që legjislacioni komunist i jepte formalisht të drejta të barabarta me burrin, në kodin penal të kohës mbeten gjurmët e pranimin të heshtun të një kulture maskiliste. Nuk mund të mohohen gjithsesi hapat përpara, por emancipimi i grues i nënshtrohej kufizimeve të dukshme ideologjike dhe kulturore, si të gjitha lëvizjet tjera që do të ndërmerre ai regjim.

Në kushtet e sotme Shqipnia ka nevojë për një feminizëm autentik që të ketë në fokus problemet e mëdha të shoqnisë shqiptare ku femna asht e papërkrahun dhe e dhunueme, e shfrytzueme dhe e keqtrajtueme. Ajo që nevojitet urgjentisht nuk asht ashpërsimi i kuadrit ligjor për ata që cënojnë figurën e saj, por një diskriminim pozitiv edhe i përkohshëm ndaj figurës së saj, pra dhanja e ma shumë mundësive ligjore për me pase akses si e pamvarun në jetën shoqnore. Së dyti feminizmi duhet të krijojë një kulturë respekti dhe paprekshmënie të personit, tue e ngulitë këtë gja nepërmjet shkollës dhe dijes. Duhet të nxjerrim mësim nga gabimet

që feminizmi ka ba në Perëndim, në fakt nuk e naltsojmë figurën e nanës tue e poshtnue atë atnore, përkundër, vetëm afrimi i këtyne dy figurave përplotësuese të njena-tjetrës dhe domosdoshmënia e tyne e barabartë në planin afektiv i japin grues të drejtat e mohueme në familje. Asht e vërtetë që puna ka karakter emancipues, por jo gjithmonë asht e mundun për gruen me ushtrua një profesion, të qenit nanë asht një *profesion* fisnik dhe parësor, prandaj shoqnia duhet t'ia njohin grues këtë rol tue e mbështetë ekonomikisht atë pa pasë nevojë të domosdoshme me punue.

Feminizmi nuk mund të jetë një lëvizje politike që herë mbas here instrumentalizohet dhe përfundon në prehnin e kësaj apo asaj partie, ai asht një nevojë e kohës dhe duhet përpunue në ndërgjegjen e kombit për t'i dhanë zgjidhje një problemi shekullor. Argumenti cilësor në favor të grues duhet ta braktisin njëherë e mirë atë sasior: *grueja asht forca ma pozitive e shoqnisë shqiptare dhe meriton një trajtim ma intensiv nga ana e saj.*